



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 64241/25
Nr. i Eq. / Br. sht. - 1 -
Data: / Datum: 23. 12. 25

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës



01 Nr. PB 161/25 23/12/2025

Në bazë të nenit 44.1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 31 të Statutit të Komunës, dhe nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për Punën e Kuvendit, si dhe sipas kërkesës së Kryetarit të komunës, Kryesuesja e kuvendit të komunës:

Ju fton:

Të merrni pjesë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e cila do të mbahet më datë **30 dhjetor 2025 (e martë)** me fillim në ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete;
3. Propozim-vendim për aprovimin e listës së pronave komunale për vitin 2026;
4. Draft Plani i Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026;
5. Draft Plani i Punës i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026;
6. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25196/25 i datës 03.06.2025, për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzi" në Vushtri, sipas gjendjes faktike;
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 25199/25 i datës 03.06.2025, Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtri, sipas gjendjes faktike;
8. Propozim-vendim për anulimin e vendimit me numër të protokollit Nr. 108/24 i datës 03.06.2024, lidhur me pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.
9. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 18/25 i datës 30.01.2025, me të cilin lejohet ndarja e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore;
10. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 29309/25 i datës 26.06.2025 lidhur me miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri;

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

